REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 69 datë 26.07.2018**

**SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI**

| | |
|---|---|
| **Autoriteti kontraktor** | Bashkia Rrogozhinë |
| **Organi auditues** | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| **Numri i procedurave të audituara** | 9 (nëntë) |
| **Lloji i procedurës/ave të audituara** | 6 procedura "Të hapura";<br>1 procedurë "Shërbim Konsulence";<br>1 procedurë "Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës";<br>1 procedurë "Kërkesë për propozim" |
| **Konstatimet kryesore** | Janë audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit 9 (nëntë) procedura prokurimi, ku ka rezultuar se:<br>• Në dy procedura, Autoriteti Kontraktor ka hartuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.<br>• Në dy procedura, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.<br>• Në një procedurë, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përdorimin e procedurës "*Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*", në kundërshtim me nenin 33, pika 2, gërma "c", të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, të cilit është referuar në përzgjedhjen e kësaj lloj procedure. |

| | |
|---|---|
| | • Në katër procedura prokurimi Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 53, pika 3, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në secilën procedurë.<br>• Në dy procedura, Autoriteti Kontraktor nuk ka bërë oponencë teknike. Mos-administrimi në dosjen e tenderit, e oponencën teknike, si pjesë e projektit teknik, është në kundërshtime me parashikimet e nenin 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar |
| **Masat e marra** | Referuar nenit 72, pika 1/e/dh/gj/i të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, APP vendosi:<br>• Të penalizojë me gjobë titullarin e Autoritetit Kontraktor<br>• Të penalizojë me gjobë tre anëtarë të Njësisë së Prokurimit.<br>• Të penalizojë me gjobë tre anëtarë të Komisionit të Përllogaritjes së Fondit limit<br>• Të penalizojë me gjobë tre anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.<br>• T'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore për një anëtar të Njësisë së Prokurimit. |